



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 42/6 prot.

Tiranë, më 4.2.2022

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 479, datë 3.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Arben Dosti
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 24.1.2022, është njoftuar vendimi nr. 479, datë 3.12.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Arben Dosti, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 479, datë 3.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

### I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dosti, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1<sup>1</sup> e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Dosti, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si *ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si *KLJG*), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Arben Dosti”, ka referuar për subjektin se:

- i. Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit z. Arben Dosti, nr.\*\*\* prot., datë \*\*.11.2017, ka referuar “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Arben \*\*\* Dosti”. Në vijim të informacioneve të ardhura nga institucionet e verifikimit, DSIK, me anë të raportit nr.\*\*\* prot., datë \*\*.2.2021<sup>2</sup>, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit dhe i ka referuar Komisionit: “Papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Arben \*\*\* Dosti”.

2.2.1 Referuar përmbajtjes së raportit të përditësuar dhe të deklasifikuar pjesërisht, përgatitur nga DSIK, pas administrimit të informacioneve përkatëse shkresore, ka rezultuar se:

2.2.2 Për subjektin e rivlerësimit ka dyshime se mund të ketë qenë i përfshirë në trafikun e narkotikëve, si dhe të shfrytëzimit të prostitucionit në shtete të huaja (Greqi/Itali), në bashkëpunim me persona të tjerë dhe, se gjatë viteve 1997 – 1998, dyshohet se ka qenë i dënuar me burg në Milano, Itali, për trafik lëndësh narkotike, periudhë në të cilën mendohet të ketë përdorur gjeneralitete të tjera. Gjatë periudhës në të cilën subjekti i rivlerësimit ushtron detyrën si gjyqtar, disponohen të dhëna të cilat ngrenë dyshime se ka pasur kontakte me disa persona të përfshirë në trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike/krimin e organizuar, me të cilët ka njohje shoqërore. Gjithashtu, Institucioni i verifikimit ka informuar se, për subjektin e rivlerësimit Arben Dosti, ngrihen dyshime për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës<sup>3</sup>, me qëllim lirim nga burgu të një të pandehuri.

<sup>1</sup> Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

<sup>2</sup> Deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. \*\*\*, datë \*\*.3.2021.

<sup>3</sup> DSIK po ashtu informon se institucionet verifikuese, kanë ndarë informacione me institucionet shtetërore.

2.3 **KLGGJ**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, dosjeve të përzgjedhura me short dhe të dhënave nga burimet arkivore, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për aftësitë profesionale.

**3.** Për sa më sipër, përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

**3.1 Për vlerësimin e pasurisë.** [...] *Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë në përputhje me pikën 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës. Ai ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij dhe personave të lidhur. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dosti, nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues ka çmuar se pasaktësitë në deklaram nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaramet e pasakta të konstatuara nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se, për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut te drejtësia. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dosti, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...] (f. 33 - 34 e vendimit).*

**3.2 Për kontrollin e figurës.** [...] *Komisioni i qëndron konstatimit fillestar se për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Dosti, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës. Si përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dosti, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...] (f. 42 e vendimit).*

**3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale.** [...] *Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku, dy çështjeve të tjera të trajtuara nga Komisioni, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni ka çmuar se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016 [...] (f. 64 e vendimit).*

Në këto rrethana, Komisioni, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: (ndër të tjera, si pjesë e dispozitivit) [...] *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dosti [...].*

## **II. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

4. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

5. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

6. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

7. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 479, datë 3.12.2021, çmon se ai është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me: (i) rezultatet e hetimit mbi kontrollin e kriterit të pasurisë; (ii) rezultatet e hetimit mbi kontrollin e kriterit të figurës; dhe (iii) rezultatet e hetimit mbi vlerësimin profesional.

8. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 479, datë 3.12.2021, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

## **III. Analiza e shkaqeve të ankimit**

### **III.A. Kontrolli i pasurisë**

9. Lidhur me rivlerësimin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ka në vëmendje se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit ("Vetting" dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

10. Po ashtu, Komisioneri Publik i referohet në këtë aspekt dhe interpretimit gjyqësor, që gjen pasqyrim në jurisprudencën e Kolegjit, si gjykata e procesit, që shqyrton çështjet e

juridiksionit të rivlerësimit dhe vendos standardet përkatëse, bazuar në parimet e përgjithshme të një procesi të rregullt ligjor.

**11.** Nga aktet e administruara në dosje të Komisionit rezulton se pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dosti, dhe personat e lidhur me të, në Deklaratën “Vetting”, dorëzuar në ILDKPKI, në datën 25.1.2017, janë si vijon:

i. Apartament banimi me sip. (rreth 80 m<sup>2</sup>), në bashkëpronësi, privatizuar nga shteti në vitin 1992, në bazë të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, me vendndodhje Kuçovë. I pavlerësuar që nga koha e blerjes. Pjesa takuese 1/3;

ii. Autoveturë, marka “Mercedez Benz”, blerë në vitin 2003, me të ardhura nga puna. Vlera 800,000 lekë. Pjesa takuese 100%;

iii. Hua dhënë shtetasve \*\*\*,\*\* dhe \*\*\*,\*\*\*, në shumën 100.000 euro, me kontratën nr. \*\*\* rep./\*\*\* kol., datë \*\*.4.2014;

iv. Depozitë në bankën \*\*\*, të ardhura nga puna e bashkëshortit. Vlera 50.000 euro, pjesa takuese 100% (deklaruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit);

v. Depozitë në bankën \*\*\*, të ardhura nga puna e bashkëshortit. Vlera 45.000 euro, pjesa takuese 100% (deklaruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit);

vi. Depozitë në bankën \*\*\*, vlera 4.000.000 lekë, pjesa takuese 100%. (deklaruar nga nëna e subjektit të rivlerësimit).

**12.** Referuar këtyre deklarimeve, rezulton se në total pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur me të, në momentin e dorëzimit të Deklaratës “Vetting”, është në shumën 4.950.000 lekë dhe 195.000 euro (pa përfshirë këtu vlerën e apartamentit në Kuçovë, të përfutur nga privatizimi).

**13.** Subjekti i rivlerësimit, në Deklaratën “Vetting” dhe akti i titulluar: “Shpjegime lidhur me deklaratimet për pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre”, që i është bashkëlidhur deklaratës “Vetting”, ndër të tjera<sup>4</sup>, deklaron si burim të ardhurash për krijimin e këtyre pasurive:

i. Të ardhurat nga emigracioni në shtetin e Greqisë, nga viti 1992 – 2000, në total në shumën prej 35.000.000 dhrahmi, konvertuar në vlerën prej 14.000.000 lekë;

ii. Të ardhurat nga punësimi në shoqërinë “\*\*\*.\*\*\*”, në formën e partneritetit, për periudhën shtator 2000 deri në vitin 2010, në shumën nga 8.000.000 lekë deri 10.000.000 lekë;

iii. Të ardhurat nga shitja e lokalit në Kuçovë, në shumën prej 12.800.000 lekë;

iv. Të ardhurat nga puna si avokat për periudhën 2008 – 2011, mbi 5.000.000 lekë.

**14.** Nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit rezulton se këto pasuri<sup>5</sup> janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe në Deklaratën e interesave private, para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI, në datën 13.1.2014, me burim krijimi të referuar nga: *puna si emigrant, sipërmarrës dhe avokatia.*

---

<sup>4</sup> Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhe: (i) Të ardhurat nga dhënia me qira e lokalit për periudhën 1998 deri 2004, privatizuar nga nëna e tij në vitin 1991 dhe shitur në vitin 2005, në total shumën prej 5,000,000 lekë; (ii) të ardhurat nga puna si jurist në Komunën \*\*\*, Kuçovë, për periudhën \*\* janar 2007 deri në \*\* dhjetor 2008, shumën prej 690.335 lekë; (iii) të ardhura nga paga në shkollën e Magjistraturës, nga tetori 2011 deri në nëntor 2013, shumën prej 1.045.330 lekë; (iv) të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin \*\*\*, Fier, për periudhën \*\*.2.2012 deri \*\*.6.2013, shumën prej 102.600 lekë.

<sup>5</sup> Përveç pasurisë depozitë bankare në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit.

**15.** Nga shqyrtimi në tërësi i vendimit të Komisionit, akteve të administruara në fashikullin e hetimit administrativ, si dhe në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si burim krijimi për këto pasuri janë deklaruar të ardhurat nga: (i) *emigracioni*, (ii) *bashkëpunimi me shoqërinë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k.*, (iii) *shitja e një njësie shërbimi në Kuçovë dhe* (iv) *avokatia*. Ndërkohë, subjekti i rivlerësimit, për pjesën më të madhe të të ardhurave të tjera të realizuara ndër vite, deklaroi se kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të jetesës.

**16.** Komisioni, pasi ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk provojnë plotësisht, me dokumentacion justifikues ligjor, të ardhurat e deklaruar si të realizuara para fillimit të detyrës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, duke i kërkuar të paraqesë argumentet/shpjegimet e tij përfundimtare, si edhe të depozitojë prova të reja të mundshme për të dokumentuar ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruar, ku bëjnë pjesë edhe të ardhurat e referuara prej tij si burim krijimi i pasurive të deklaruar në Deklaratën “Vetting”, të konstatuara si pasuri të krijuara/trupëzuara para fillimit të detyrës.

**17.** Pas administrimit të qëndrimit të subjektit të rivlerësimit, Komisioni, duke marrë në konsideratë prapësimet e subjektit të rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] *subjekti i rivlerësimit në Deklaratën “Vetting” ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës [...]* (f. 33 e vendimit).

**18.** Komisioneri Publik, në vlerësim të vendimit nr. 479, datë 3.12.2021, dhe akteve të administruara në fashikullin përkatës, në rastin konkret, çmon se përfundimi i arritur nga Komisioni nuk është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, duke mos gjetur mbështetje argumentimi i përdorur në një vlerësim të drejtë të provave dhe jurisprudencës së Kolegjit, për shkaqet që trajtohen në këtë ankim.

**19.** Komisioneri Publik, nisur nga rrethanat faktike të rastit konkret, ku pasuritë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit janë krijuar para fillimit të detyrës, referon më së pari jurisprudencën e Kolegjit, në drejtim të interpretimit të dispozitave përkatëse kushtetuese dhe ligjore, posaçërisht vendimet e juridiksionit të rivlerësimit nr.12/2020, nr. 2/2019, nr. 6/2019 dhe nr. 8/2019.

19.1 Në këto rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se pasuritë e deklaruar në Deklaratën “Vetting”, referuar rrethanave konkrete të faktit, i nënshtrohen kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklarimit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim apo ndonjë lloj kriteri përcaktues, sipas standardeve të vendosura nga legjislacioni i posaçëm dhe jurisprudenca tashmë e konsoliduar e Kolegjit.

19.2 Sa më sipër, nisur nga fakti se të gjitha pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, pretendohen se kanë të njëjtat burime të ardhurash, Komisioneri Publik, në këtë ankim do ndalet në përshkrimin dhe në analizën e ligjshmërisë së burimit të të ardhurave të deklaruar, për të cilat ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni.

### III.A.1 Analiza e burimeve të të ardhurave të deklaruara

#### 20. (i) Lidhur me të ardhurat e deklaruara me burim nga emigracioni

20.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka përfiturar të ardhura nga puna e tij si emigrant ekonomik në shtetin grek, për periudhën nga viti 1992 deri në vitin 2000, në shumën **14.000.000 lekë**. *Subjekti i rivlerësimit ka vetëdeklaruar<sup>6</sup> se këto të ardhura janë të padokumentuara.*

20.2 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *Qëndrimi im në shtetin e Greqisë nuk ka qenë me leje qëndrimi, por me vizë turistike. Vizën e parë e kam marrë në vitin 1996, në Ambasadën greke, në Athinë, dhe vizën e dytë, në vitin 1999, në Konsullatën greke, në Gjirokastrë. Pasaportën me vizë të marrë në vitin 1996 nuk e disponoj. Pasaportën me vizë të marrë në vitin 1999 e disponoj, e kam paraqitur si provë dhe po e paraqes përsëri. Leje qëndrimi dhe punësimi nga shteti i Greqisë nuk kam pasur. Kam punuar pa leje pune, siç punonin gjithë shqiptarët në këtë periudhë në Greqi. Në lidhje me krijimin e të ardhurave, i qëndroj përsëri deklaratës së dhënë në ILDKPKI, në vitin 2014 dhe 2017 [...] <sup>7</sup>.*

20.3 Në fashikullin e hetimit administrativ të Komisionit, lidhur me këto të ardhura, ndër të tjera, gjenden të administruara: (i) kopje të fletës së pasaportës, ku pasqyrohet viza njëvjeçare për kalimin në shtetin grek, lëshuar për subjektin e rivlerësimit në vitin 1999; (ii) akt marrëveshje për dhënie huaje, e datës \*.5.2000, me palë huadhënëse znj. \*\*\*.\*\*\*, (nëna e subjektit të rivlerësimit), dhe palë huamarrëse shtetasin \*\*\*.\*\*\*<sup>8</sup>; (iii) deklaratë noteriale e datës \*.10.2000, me palë deklaruese subjektin e rivlerësimit dhe shtetasin \*\*\*.\*\*\*<sup>9</sup>; (iv) 2 prokura të posaçme, me anë të të cilave subjekti autorizon avokatët për të marrë informacion në bankën \*\*\*, në territorin grek, për të dhëna në lidhje me llogaritë bankare të pretenduara prej tij<sup>10</sup>.

20.4 Për sa më lart, rezulton se Komisioni ka arritur në përfundimin: [...] *nga analizimi në tërësi i shpjegimeve dhe provave të administruara, Komisioni krijoi bindjen se gjatë viteve '90 deri në vitin 2000, subjekti i rivlerësimit ka qenë emigrant ekonomik në shtetin grek... Sa i përket ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, Komisioni vlerëson se në arsyetimin e tij duhet të mbajë parasysh rrethana të tilla, të cilat përbëjnë fakte të njohura botërisht, se remitancat nga jashtë në ato vite kanë qenë në nivele të larta dhe kryesisht të pashoqëruara me burime legale të pagesës nga punëdhënësit dhe për më tepër të pataksuara në Shqipëri... Në vlerësim të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti, Komisioni vëren se ai ka punuar në Greqi në mënyrë informale, pa leje qëndrimi/pa leje pune dhe, në këtë këndvështrim, rezulton se ka qenë në pamundësi objektive për deklarimin e këtyre të ardhurave si individ në atë shtet, e, për rrjedhojë, as për kryerjen e pagesës së detyrimeve tatimore përkatëse lidhur me to [...] (f. 29-30 e vendimit).*

<sup>6</sup> Në dokumentin *Shpjegime lidhur me deklaratën për pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre*, ndodhur në Aneksin 4/10, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>7</sup> Referohuni procesverbalit në fashikullin e ILDKPKI-së.

<sup>8</sup> Referuar kësaj aktmarrëveshjeje, rezulton se personi i lidhur i ka dhënë hua pa interes shtetasit \*\*\*.\*\*\*, shumën prej 20.000.000 dhrahmi (konvertuar në shumën prej rreth 8.000.000 lekë), për një afat kthimi deri në datën \*.12.2000.

<sup>9</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*.10.2000, redaktuar nga noteri publik, znj. \*\*\*.\*\*\* Referuar kësaj deklarate, shtetasi \*\*\*.\*\*\* deklaroi se i ka kthyer subjektit të rivlerësimit shumën prej 18.000.000 dhrahmi (konvertuar në shumën prej rreth 7.200.000 lekë), deklaruar si të marra hua prej babait të subjektit në muajin prill të vitit 2000.

<sup>10</sup> (i) Prokurë e posaçme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*.10.2018, redaktuar nga noteri publik, z. \*\*\*.\*\*\*, dhe (ii) Prokura e datës \*.6.2020 në gjuhën greke, e përkthyer në gjuhën shqipe, konfirmuar me dokumentin vërtetim përkthimi nr. \*\* rep., datë \*.1.2021, redaktuar nga noteri publik, z. \*\*\*.\*\*\*

20.5 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, vlerëson se të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, të pretenduara me burim nga emigracioni, nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës, mbeten në nivel deklarativ si me kohën, mënyrën dhe territorin ku janë krijuar, duke mos gjetur mbështetje në dokumentacion, i cili duhet të provojë: (i) ekzistencën e një burimi real të ardhurash të ligjshme dhe (ii) vlerën reale të të ardhurave të krijuara nga personi deklarues dhe jo të mundësisë objektive për t'i realizuar këto të ardhura me punë, duke i ekuivalentuar me mundësinë potenciale për të krijuar të ardhura gjatë periudhës së pretenduar.

20.6 Komisioneri Publik në këtë vlerësim bazohet dhe jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit në raport me trajtimin e remitancave, për më tepër të krijuara nga vetë subjekti i rivlerësimit, sipas së cilës jo gjithmonë remitancat mund të konsistojnë në dërgesa të vlerave monetare të krijuara nga burime të ligjshme dhe të konsiderohen si të ardhura të ligjshme në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në kuptim të standardit të vendosur nga neni D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, lidhur me përmbushjen e detyrimeve tatimore përkatëse. Ky interpretim i Kolegjit gjen shprehje posaçërisht në vendimet e juridiksionit të rivlerësimit nr.14/2021, nr. 21/2021 dhe nr. 23/2020.

20.7 Sa më lart, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë të kundërtën e barrës së provës, lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të deklaruara me burim nga emigracioni dhe, si të tilla, ato nuk duhen konsideruar si të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës, dispozitë e cila kërkon që për përcaktimin e ligjshmërisë së të ardhurave duhet që të ardhurat të jenë krijuar nga burime të ligjshme, të jenë deklaruar dhe për to të jenë paguar detyrimet tatimore përkatëse.

**21.** (ii) Lidhur me të ardhurat e deklaruara me burim nga bashkëpunimi me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k.

21.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka përfituar të ardhura nga puna, bashkëpunimi/partneriteti në biznes me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., shumën prej **8.000.000 deri 10.000.000 lekë**. Subjekti i rivlerësimit ka vetëdeklaruar se marrëdhënia me këtë shoqëri ka qenë e paformalizuar dhe, si rrjedhojë, këto të ardhura janë të padokumentuara.

21.2 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] Shoqëria \*\*\* ka pasur dhe ka si ortak të vetëm, njëkohësisht dhe administrator, z. \*\*\*.\*\*\* Ky është një miku im i hershëm... Pas kthimit tim në Shqipëri, më ka ofruar të punojmë bashkë në shoqërinë e tij... Siç jam shprehur edhe në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, në datën 19.09.2014, bashkëpunimi ynë ka qenë miqësor dhe i padokumentuar në aktin e themelimit apo në statut të shoqërisë... Nga momenti i fillimit të bashkëpunimit, tremujori i fundit i vitit 2000 deri në periudhën e verës së vitit 2002, përfshirja në veprimtarinë e shoqërisë ka qenë me kohë të plotë. Kjo tregohet edhe në librezën e punës... Asnjëherë nuk jam paguar me pagë fikse, por kam marrë shpërblim në përqindje, të cilën e llogarisnim në përfundim të punës [...].

21.3 Në fashikullin e hetimit administrativ të Komisionit, lidhur me këto të ardhura, ndër të tjera, gjenden të administruara: (i) aktmarrëveshje për dhënie huaje<sup>11</sup>, e datës \*\*.5.2000, me palë huadhënëse znj. \*\*\*.\*\*\* (nëna e subjektit të rivlerësimit) dhe palë huamarrëse shtetasin

<sup>11</sup> Konfirmuar me vërtetim nënshkrimi nr. \*\*\* rep., datë \*\*.5.2000, nga noteri publik, znj. \*\*\*.\*\*\*



\*\*\*.\*\*\*<sup>12</sup>; (ii) kopje të dokumentit Librezë pune<sup>13</sup>, në referim të së cilës subjekti figuron i regjistruar si punëtor i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën nga data \*\*1.2001 - \*\*5.2002 (informacion që konfirmohet dhe nga ISSH, Drejtoria Rajonale Berat<sup>14</sup>, nga ku rezulton se të ardhurat bruto të përfituara janë në total në shumën 138.994 lekë); (iii) vërtetim<sup>15</sup> (shkresë e thjeshtë), pa datë, lëshuar nga përfaqësuesi i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>16</sup>; (iv) akti, shkresë e thjeshtë<sup>17</sup> e shtetasit \*\*\*.\*\*\* (pa datë), në të cilën deklaron se subjekti i rivlerësimit për periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2010 ka kontribuar në funksionimin e shoqërisë; (v) shkresa e datës \*\*1.2021, e noterit publik, znj. \*\*\*.\*\*\*, e cila konfirmon se në regjistrin e përgjithshëm të akteve dhe veprimeve noteriale, në faqen me nr. \*\*\*, është regjistruar akti noterial me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*7.2000, “Kontratë huapërdorje automjeti, me palë huadhënës: \*\*\*: Arben Dosti”; (vi) vërtetim nga \*\*\* Bank<sup>18</sup>, Dega Gjirokastër (ish-Banka \*\*\*), i datës \*\*6.2018, ku konfirmohet se subjekti i rivlerësimit ka qenë klient i Bankës \*\*\*, Dega Kuçovë, me një depozitë kursimi me afat 6-mujor, çelur më datë \*\*3.2002, në shumën 1.400.000 lekë.; (vii) kontratë shitje kuotash me kusht, e datës \*\*4.2008<sup>19</sup>, me palë shitëse shtetasin \*\*\*.\*\*\* dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit (referuar kësaj kontrate, pala shitëse – z. \*\*\*.\*\*\*, në cilësinë e ortakut që zotëron 49% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., i shet palës blerëse, subjektit të rivlerësimit, 20% të kuotave të kapitalit të kësaj shoqërie, në shumën 250.000 euro, me dhënien e miratimit nga ortakut tjetër); (viii) kontratë huaje,<sup>20</sup> e datës \*\*12.2012, lidhur midis subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e huadhënësit, dhe shtetasit \*\*\*.\*\*\*, në cilësinë e huamarrësit, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit i ka dhënë hua pa interes shtetasit \*\*\*.\*\*\*, shumën prej 122.000 euro, kundrejt garancisë për shlyerjen e shumës së marrë hua, të një pasurie të paluajtshme të llojit *apartament banimi*, me sipërfaqe 127,6 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Tiranë <sup>21</sup>.

21.4 Për sa më lart, rezulton se Komisioni ka arritur në përfundimin: [...] *bazuar në prova e indicie të besueshme, Komisioni krijoi bindjen se pas kthimit nga emigracioni, për periudhën 2000 – 2010, subjekti i rivlerësimit ka qenë në marrëdhënie me shoqërinë “\*\*\*\*.” sh.p.k., dhe se ka përfituar të ardhura nga ky bashkëpunim... Gjithashtu, rezulton se zoti \*\*\*.\*\*\*, në vazhdimësi, ka konfirmuar marrjen e vlerës monetare në vitin 2000, si kontribut nga subjekti i rivlerësimit, përdorimin e saj për nevojat të aktivitetit tregtar, si edhe bashkëpunimin në biznes*

<sup>12</sup> Referuar kësaj aktmarrëveshje, personi i lidhur i ka dhënë hua pa interes shtetasit \*\*\*.\*\*\*, shumën prej 20.000.000 drahmi (konvertuar në shumën prej rreth 8.000.000 lekë), për një afat kthimi deri në datën \*\*12.2000.

<sup>13</sup> Dokument, për të cilin është vërtetuar njësisë me origjinalin, nëpërmjet vërtetimit noterial nr. \*\* rep., datë \*\*1.2021, redaktuar nga noteri publik, z. \*\*\*.\*\*\*

<sup>14</sup> Referohuni shkresës nr. \*\*\* prot. dhe nr. \*\*\* prot., datë \*\*1.2021.

<sup>15</sup> Dokument i depozituar nga subjekti, bashkëlidhur shpjegimeve të dhëna prej tij në datën \*\*9.2014n në ILDKPKI, në përgjigje të pyetjeve të dërguara me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*9.2004.

<sup>16</sup> Referuar këtij vërtetimi, përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., shtetasi \*\*\*.\*\*\*, deklaron se që prej fillimit të punës dhe më pas, z. Arben Dosti ka kontribuar financiarisht shumën prej 8.000.000 lekë, nëpërmjet kontratave verbale të huas, shumë e cila është shlyer periodikisht nga shoqëria deri në vitin 2010. Për këtë kontribut është shpërblyer periodikisht afërsisht në shumën prej 8.000.000 lekë, duke filluar që nga viti 2000 deri në vitin 2010, në varësi të punëve dhe fitimit që ka pasur shoqëria për punët që ka kryer gjatë kësaj periudhe. Marrëdhënia e bashkëpunimit me z. Arben Dosti, përveç vitit të parë të bashkëpunimit, nuk ka qenë e formalizuar, pasi ka qenë një marrëdhënie miqësore bashkëpunimi, si e tillë filloi e përfundoi në vitin 2010.

<sup>17</sup> Depozituar nga subjekti si dokumentacion bashkëlidhur Deklaratës “Vetting”, ndodhur në Aneksin 4/4, në dosjen e ILDKPKI-së. Depozituar sërish si pjesë e dokumentacionit bashkëlidhur përgjigjeve të Pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni.

<sup>18</sup> Vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë \*\*6.2018.

<sup>19</sup> Kontratë shitje me kusht (kuotash) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*4.2008, redaktuar nga noteri publik, znj. \*\*\*.\*\*\*

<sup>20</sup> Kontratë huaje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*12.2012, redaktuar nga noteri publik, znj. \*\*\*.\*\*\*

<sup>21</sup> Kontratë hipotekimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*12.2012.

me të. Në vijim, vërehet se prej tij janë konfirmuar plotësisht deklaratimet e bëra nga subjekti, përfshirë këtu edhe faktin se kryesisht marrëdhënia e tyre ka qenë e paformalizuara, përveçse vitit të parë të bashkëpunimit, duke sqaruar se, krahas kthimit të shumës së marrë hua, z. Arben Dosti është shpërblyer prej tij gjatë viteve 2000 – 2010, për punën që ka kryer në këtë shoqëri [...] (f. 30 - 31 e vendimit).

21.5 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, vlerëson se të ardhurat e deklaruara nga subjekti, të pretenduara me burim punësimin/marrëdhënie interesi në shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 të aneksit të Kushtetutës, mbeten në nivel deklarativ në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë me dokumentacion ligjor burimin e krijimit të këtyre të ardhurave, as në formën e një marrëdhënieje punësimi me këtë shoqëri dhe as në formën e një marrëdhënieje kontraktuale të një lloji tjetër.

21.6 Komisioneri Publik, në këtë vlerësim, i referohet jurisprudencës të Kolegjit, ku gjen interpretim gjyqësor rëndësia e veçantë që merr provueshmëria me dokumentacion e pretendimeve të ngritura nga subjektet në procesin e vlerësimit të kriterit pasuror. Ky interpretim i Kolegjit gjen pasqyrim, ndër të tjera, në vendimet e juridiksionit të rivlerësimit nr. 5/2020, nr.19/20219, nr.14/2019, nr. 7/2019 dhe nr. 9/2018.

21.7 Sa më lart, Komisioneri Publik vlerëson se vlera e të ardhurave të deklaruara si e realizuar nga bashkëpunimi me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. nuk provohet se është një e ardhur e realizuar nga një burim i ligjshëm dhe për të cilën janë paguar detyrimet përkatëse tatimore, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së Kolegjit.

## **22. (iii) Lidhur me të ardhurat e deklaruara me burim nga shitja e lokalit në Kuçovë**

22.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka përfiturar të ardhura nga shitja e lokalit në Kuçovë në vlerën **12.800.000** lekë.

22.2 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, lidhur me këto të ardhura, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *nëna ka pasur në pronësi pasurinë e llojit njësi tregtare, të privatizuar prej saj në vitin 1991... Në vitin 1997, fillim viti 1998, lokalit i janë bërë disa shtesa, para dhe pas, dhe sipërfaqja është dyfishuar. Gjithashtu, në vitin 2002, kur jam kthyer nga Greqia, është kryer rikonstruksioni i kësaj pasurie, duke e përshtatur sipas kohës lokalit, dhe se më pas lokali është shitur në shumën prej 12.800.000 lekë [...].*

22.3 Nga ZVRPP Kuçovë<sup>22</sup> konfirmohet blerja e kësaj pasurie prej nënës së subjektit të rivlerësimit nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, Dega Kuçovë. Gjithashtu, konfirmohet se në datën \*\*.1.2005, personi i lidhur, znj. \*\*\*.\*\*\*, e ka shitur<sup>23</sup> pasurinë në fjalë, Njësi shërbimi me sipërfaqe 59 m<sup>2</sup>, shtetasit \*\*\*.\*\*\*, në vlerën 3.900.000 lekë.

22.4 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me mospërputhjet e evidentuara mes çmimit të shitblerjes së kësaj pasurie, të referuar në kontratë, dhe vlerës së pretenduar nga ana e tij si të përfiturar nga shitja e saj, në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *Çmimi real i shitjes së dyqanit nga nëna ime është 12.800.000 lekë. Kur është shkuar te noteri dhe është*

<sup>22</sup> Referohuni shkresës nr. \*\*\* prot., datë \*\*.9.2017.

<sup>23</sup> Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme nr. \*\* rep., nr. \*\* kol., datë \*\*.1.2005.

*parë lista e tarifave që paguheshin tek noteri, me kërkesë të blerësit (djalit të tij që paguante realisht lekët dhe që jetonte dhe jeton në Itali) dhe me orientim te noterit, është vendosur në akt shuma 3.900.000 lekë. Nëna ime ra dakord dhe kështu u përpilua akti [...].*

22.5 Në fashikullin e hetimit administrativ të Komisionit, lidhur me këto të ardhura, ndër të tjera, gjenden të administruara: (i) deklaratë noteriale e datës \*\*.12.2018, të shtetasit \*\*.\*\*\*, identifikuar si blerësi i kësaj pasurie, në të cilën ka deklaruar se shuma reale që ka paguar për blerjen e lokalit është 12.800.000 lekë; (ii) vetëdeklarim për legalizim e shtesës, i datës \*\*.10.2006, i shtetasit \*\*.\*\*\*.

22.6 Për sa më lart, rezulton se Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] *ka krijuar bindjen se Njësia e shërbimit është shitur realisht më shumë se vlera e përcaktuar në kontratë, por se gjithsesi rezulton se nuk janë paguar plotësisht detyrimet tatimore për çmimin e pretenduar. Trupi gjykues çmon se, në këtë rast, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi subjekti i rivlerësimit, qoftë edhe të karakterit etik, vlerësuar kjo për kohën kur është kryer transaksioni, si edhe për faktin se titullare e pasurisë ka qenë vetëm nëna e tij, e cila ka pasur të drejta dhe detyrime të plota në këtë marrëdhënie juridike. Nga ana tjetër, Komisioni vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit se ka përfituruar një pjesë të vlerës së përfituruar nga shitja e kësaj pasurie, fakt ky i pranuar nga nëna e tij, me argumentin se kjo ka ndodhur për shkak të pagesës së çmimit të privatizimit dhe investimeve të kryera tek kjo pasuri nga subjekti, ku përfshihen edhe shtesat funksionale të kësaj pasurie të pasqyruara në vetëdeklarimin për legalizimin e shtesës së datës \*\*.10.2006 [...] (f. 32 e vendimit).*

22.7 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, vlerëson se të ardhurat e deklaruara nga subjekti, të pretenduara me burim nga shitja e lokalit në Kuçovë, në vlerën 12.800.000 lekë, nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 të aneksit të Kushtetutës.

22.7.1 Pretendimet e subjektit të rivlerësimit në mungesë të provave dokumentare mbeten të një natyre deklarative dhe vijnë në kontradiktë me përmbajtjen e një akti me vlerë të plotë ligjore, siç është kontrata e shitblerjes së pasurisë të paluajtshme nr.\*\* rep., nr. \*\* kol., datë \*\*.1.2005, në të cilën çmimi i shitjes është përcaktuar në vlerën 3.900.000 lekë.

22.7.2 Sa më lart, në kushtet kur nga aktet në dosje të Komisionit, nuk u provua shitja e Njesisë së shërbimit në vlerën 12.800.000 lekë, si dhe as pagesa e detyrimit tatimor për vlerën e pretenduar, Komisioneri Publik vlerëson se diferenca midis çmimit të shitjes të kontraktuar me çmimin e blerjes të pretenduar, nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme, bazuar dhe në jurisprudencën përkatëse të Kolegjit.<sup>24</sup>

### ***Konkluzioni për kriterin e rivlerësimit të pasurisë***

**23.** Në përfundim, Komisioneri Publik, mbështetur në përfundimet e mësipërme për rivlerësimin e kriterit të pasurisë, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë të kundërtën e barrës së provës dhe mungesa e burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e deklaruara, e klasifikon subjektin e rivlerësimit në situatën e parashikuar nga neni D, pikat 1, 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për kontrollin e pasurisë.

<sup>24</sup> Referohuni vendimeve të Kolegjit për juridiksionin e rivlerësimit nr.11/2019, nr. 34/2019.

23.1 Komisioneri Publik konstaton se Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, në vlerësim të të gjitha të dhënave të mbledhura gjatë hetimit administrativ, ka konkluduar se të ardhurat të cilat subjekti i rivlerësimit ka arritur t'i provonte me dokumentacion ligjor, kanë vlerën **10.246.150 lekë**, ndërkohë që pasuria e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, me burim këto të ardhura, rezulton të jetë në vlerën **195.000 euro** dhe **4.950.000 lekë** (në total rreth **31.000.000 lekë**).

### **III.B. Kontrolli i figurës**

**24.** DSIK, me raportin mbi kontrollin e figurës, nr.\*\*\* prot., datë \*\*.11.2017, ka referuar “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Arben \*\*\* Dosti”. Në vijim të informacioneve të ardhura nga institucionet e verifikimit, sikurse parashtruar më sipër, në pikën 2.2.2 të këtij ankimi, DSIK, me anë të raportit nr.\*\*\* prot., datë \*\*.2.2021<sup>25</sup>, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit dhe i ka referuar Komisionit: “*Papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Arben \*\*\* Dosti*”.

24.1 Komisioni, në vendimin nr. 479 datë 3.12.2021, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjet asnjë provë, si edhe nuk u konstatua asnjë rrethanë, qoftë edhe në formën e ndonjë të dhëne/indicieje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, që të lidhte përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprimtari të kundërligjshme dhe/apo të lidhej me dyshimet e ngritura nga institucionet e verifikimit për dënimin e tij me burgim në shtet të huaj, duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

**25.** Komisioneri Publik, në analizë të raportit të organeve ligjzbatuese, akteve të administruara në dosje të Komisionit dhe në një vlerësim tërësor të rrethanave të verifikuara nga hetimi administrativ, vlerëson të nënvizojë sa vijon.

25.1.1 Rezulton se, bazuar në informacionet që përmban raporti i përditësuar i përgatitur nga DSIK, Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2021, i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, për të kërkuar informacion pranë autoriteteve gjyqësore përkatëse në lidhje me faktin nëse për subjektin e rivlerësimit (*me gjeneralitet sipas deklaramit të tij në shtojcën përkatëse të ligjit nr. 84/2016*) ekziston ndonjë vendim gjyqësor penal dhënë nga juridiksioni gjyqësor në Republikën e Greqisë dhe Republikën e Italisë.

25.1.2 Mbi këtë kërkesë të Komisionit, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, më datë \*\*.11.2021, i ka përcjellë kërkesën për informacion Ministrive respektive në Republikën e Greqisë<sup>26</sup> dhe Republikën e Italisë<sup>27</sup>.

25.1.3 Megjithëse vetë Komisioni e vlerësoi si të nevojshëm marrjen e informacionit pranë autoriteteve përkatëse të Republikës së Italisë dhe Greqisë, trupi gjykues zhvilloi seancën dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Arben Dosi, në datën 25.11.2021, dhe shpalli vendimin përkatës në datën 3.12.2021, pa administruar në fashikullin e hetimit administrativ ndonjë përgjigje në lidhje me kërkesën e dërguar prej tyre, për sa më lart.

<sup>25</sup> Deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. \*\*\*, datë \*\*.3.2021.

<sup>26</sup> Shkresa nr.\*\*\* prot., datë \*\*.11.2021, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Transparencës dhe të Drejtave të Njeriut, Greqi.

<sup>27</sup> Shkresa nr.\*\*\* prot., datë \*\*.11.2021, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Italisë.

25.2 Komisioneri Publik, duke iu referuar akteve në fashikullin e vendimit të Komisionit, njoftuar më datë 24.1.2022<sup>28</sup>, akte këto të cilat kanë shërbyer për dhënien e vendimit nr. 479, datë 3.12.2021, ka konstatuar fillimisht se nuk gjenden të administruara përgjigjet e ardhura nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Italisë dhe Republikës së Greqisë.

25.2.1 Ndërkohë, në datën \*\*.1.2022, nga Komisioni është përcjellë pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë një kopje e shkresës së Ministrisë së Drejtësisë me nr.\*\*\* prot., datë \*\*.1.2022, protokolluar në Komision me nr.\*\*\* prot., datë \*\*.1.2022, me anë të së cilës dërgohet përgjigja e autoriteteve përkatëse të Republikës së Italisë, nga ku rezulton se me gjeneralitetet e subjektit nuk ka të dhëna në bankën e të dhënave të sektorit gjyqësor. Sipas komunikimit përkatës të Komisionit, kjo praktikë shkresore do t'i bashkëlidhet fashikullit përkatës së hetimit administrativ.

25.2.2 Në këto rrethana, në momentin e depozitimit të këtij ankimi, institucionit të Komisionerëve Publikë, në asnjë formë komunikimi, nuk i është vënë në dispozicion për t'u shqyrtuar ndonjë përgjigje e administruar nga ana e autoriteteve përkatëse të Republikës së Greqisë, bazuar në kërkesën e dërguar nga Komisioni për të verifikuar në rast se në ngarkim të subjektit të rivlerësimit është dhënë ndonjë vendim gjyqësor penal gjatë qëndrimit në territorin grek.

25.3 Për sa më lart, Komisioneri Publik vlerëson se për kontrollin e figurës së subjektit, z. Arben Dosti, informacionet e institucioneve verifikuese mundën eventualisht të rivlerësohen nga Kolegji, qoftë në rivlerësimin e kriterit të figurës dhe/ose në vlerësim tërësor të procedurave, për të krijuar bindjen e plotë se subjekti nuk ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë apo ndodhet në kushtet e papërshtatshmërisë për të vazhduar detyrën.

### **III.C Mbi kontrollin e aftësive profesionale**

26. Bazuar në përcaktimet e nenit E të aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale për subjektet që ushtrojnë funksionin e gjyqtarit, bazohet në aftësinë për të marrë vendime gjyqësore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të së drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën. Ndërsa për burimet dhe procedurën mbi të cilat kryhet ky vlerësim, neni 42, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të drejton në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për aq sa ky ligj gjen zbatim.

27. Referuar burimeve dhe procedurës së përcaktuar nga ky kuadër ligjor, duke përfshirë në këtë vlerësim dosjet e administruara gjatë hetimit administrativ, denoncimin e fakteve nga publiku sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, si dhe Raportin e vlerësimit profesional të hartuar nga KLGJ, nga hetimi administrativ i Komisionit, kanë rezultuar disa gjetje dhe mangësi, për të cilat subjektit të rivlerësimit, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrë prove dhe i janë kërkuar shpjegime.

28. *Denoncimi i shtetases \*\*\*,\*\*\*(\*\*)<sup>29</sup> (f. 44-46 e vendimit të Komisionit)*

28.1 Denoncuesja ngre pretendime se subjekti Arben Dosti, në shkëlqje të ligjit, ka vendosur lirim me kusht të një të dënuari (ish-bashkëshortit), dënuar për “Dhunë në familje” dhe për

<sup>28</sup> Datë në të cilin është njoftuar vendimi i Komisionit nr. 479, datë 3.12.2021, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë.

<sup>29</sup> Ankesa e protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.12.2017.

“Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake”. Nga vendimi rezulton se Komisioni ka administruar dosjen gjyqësore<sup>30</sup> që i përket çështjes penale për të cilën është dhënë vendimi nr. \*\*, datë \*\*.12.2016, me kërkues shtetasin \*\*\*.\*\*, me objekt: “Lirim me kusht”, parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal.

28.2 Komisioni ka konstatuar se me vendimin nr. \*\*, datë \*\*.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, shtetasi \*\*\*.\*\* është deklaruar fajtor për veprën penale “*Dhunë në familje*”, të parashikuar nga neni 130/a, paragrafi i 4 i Kodit Penal dhe është dënuar me 18 muaj burgim. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, duke e dënuar këtë shtetas me 12 muaj burgim. Gjithashtu, ka rezultuar se, me vendimin nr. \*\*, datë \*\*.12.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka deklaruar po ashtu fajtor shtetasin \*\*\*.\*\* për veprën penale “*Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit*”, parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, duke e dënuar me 8 muaj burgim. Me vendimin nr.\*\*, datë \*\*.2.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka kryer bashkimin e dënimeve të mësipërme, duke caktuar ndaj këtij shtetasi një dënim të vetëm prej 13 muajsh burgim.

28.3 Duke pretenduar se plotëson kriteret e nenit 64 të Kodit Penal, shtetasi \*\*\*.\*\* ka paraqitur kërkesë në gjykatë për lirim me kusht, e cila është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit.

28.4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. \*\*, datë \*\*.12.2016, e përbërë nga gjyqtari i vetëm Arben Dosti, ka vendosur: (i) pranim e kërkesës së të dënuarit \*\*\*. \*\*.; (ii) bazuar në nenin 64 të Kodit Penal, lirimin e të dënuarit, duke urdhëruar pezullimin e pjesës së mbetur pa vuajtur prej 52 ditësh burgim dhe vënien në provë për një periudhë prej 52 ditësh.

28.5 Prokurori i çështjes (i seancës) ka parashtruar se kërkuesi \*\*\*.\*\* ka dy dënime penale të dhëna për vepra penale të kryera me dashje, duke e konsideruar atë përsëritës, dhe si rrjedhojë ka pretenduar se nuk plotësohen kushtet (të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative), për aplikimin e nenit 64 të Kodit Penal, në rastin e të dënuarit \*\*\*.\*\*

28.6 Komisioni i ka kërkuar subjektin të rivlerësimit shpjegime mbi verifikimin dhe përmbushjen/plotësimin e kriterëve për aplikimin e nenit 64 të Kodit Penal dhe, si rrjedhojë, disponimin me vendim për lirim me kusht të kërkuesit \*\*\*.\*\*, krahas atyre të dhëna në arsyetimin e vendimit.

28.7 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ka deklaruar se: [...] *ndaj shtetasit \*\*\*.\*\* konstatohet se gjatë së njëjtës periudhë ndaj tij janë dhënë dy dënime penale, të cilat janë bashkuar në një dënim të vetëm nga gjykata. Diskutimi i vetëm që u ngrit gjatë gjykimit ishte ai i faktit nëse i dënuari do të konsiderohej përsëritës dhe si pasojë nuk mund të përfitonte nga drejta për lirim me kusht apo do të konsiderohej i padënuar më parë... Në kushtet kur kemi dy dënime të bashkuar në një, nuk mund të themi që kërkuesi po kryen njërin nga dënimet dhe është përsëritës për tjetrin, pasi ai po kryen një dënim të vetëm të dhënë me vendim gjyqësor. Vendimi i gjykatës për bashkimin e dënimeve nuk është një vendim vetëm për efekt ekzekutimi të vendimeve, dhënë më parë. Në këtë vendim është caktuar një dënim i ri, i vetëm për t'u vuajtur, i cili nuk është shumatorë e vendimeve të mëparshme... Qëllimi i nenit 64 të K. Penal*

<sup>30</sup> Referohuni shkresës nr. \*\* prot., datë \*\*.9.2021, e dërguar nga Komisioni dhe shkresa “kthim përgjigje” me nr. \*\* prot., datë \*\*.9.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

*është që personave t'u jepet një mundësi rehabilitimi dhe risocializimi. Në rast se dënohen përsëri, që do të thotë që procesi i rehabilitimit ka dështuar, legjislatori ka vendosur si kusht mospërfitimin nga neni 64 [...].*

28.8 Komisioni ka arritur në konkluzionin se nuk vëren problematika në vendimmarrjen e subjektit, për gjetje që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke vlerësuar se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë denoncim janë bindëse dhe se nuk ekzistojnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe/apo për figurën e subjektin e rivlerësimit, gjyqtarin Arben Dosti (f. 46 e vendimit të Komisionit).

28.9 Komisioneri Publik, mbi të njëjtin prezumim të kufijve të rivlerësimit, të përdorur nga Komisioni, konstaton se të dhënat e rezultuara nga hetimi administrativ lidhur me cilësinë e analizës dhe të argumentimit logjik të subjektit, mbeten për t'u vlerësuar sipas indikatorëve të përcaktuar nga neni 72/3, i ligjit nr. 96/2016, referuar dhe jurisprudencës të Kolegjit.

28.10 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, qëndrimi i subjekti të rivlerësimit lidhur me zbatimin e nenit 55 dhe 64 të K. Penal, për verifikimin ose jo si përsëritës në kryerjen e veprave penale, të kryera me dashje, të personit në gjykim, nuk gjen mbështetje në situatën faktike dhe juridike të rastit konkret, duke evidentuar minimalisht dobësi/mangësi në aftësitë profesionale të subjektit.

28.11 Bashkimi i dënimeve në një të vetëm nuk mund të interpretohet si rrethanë e cila karakterizon personin i cili ka kryer disa vepra penale, si person jopërsëritës dhe të legjitimijë dhënien e masës lirim me kusht. Vetë neni 55 i K. Penal, ndër të tjera, shprehet se: [...] *Kur veprimet apo mosveprimet përmbajnë elementet e disa veprave penale, si dhe kur personi ka kryer disa vepra penale për të cilat nuk është dhënë akoma vendim, gjykata cakton dënimin për çdo vepër penale dhe në përfundim jep një dënim të vetëm, që përbëhet nga dënimi më i rëndë i shtuar [...].*

28.12 Po ashtu, duket se subjekti nuk ka marrë në konsideratë as elementet e trajtuara nga Gjykata e Lartë në vendimin unifikues nr. 2, datë 25.5.2015, të cilin vetë subjekti i rivlerësimit e ka sjellë në vëmendje. Ndër të tjera, në këtë vendim unifikues është interpretuar se: [...] *(i) Natyra e veprës penale të kryer është një nga elementet më të rëndësishme që duhet të merret parasysh nga ana e Gjykatës në shqyrtimin e kërkesës për lirim me kusht. Sa më e lartë të jetë rrezikshmëria shoqërore e veprës penale të kryer, aq më i thellë duhet të jetë hetimi gjyqësor në lidhje me riedukimin e të dënuarit. (ii) Qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës është elementi i dytë që ligji parashikon për t'u trajtuar në raportin e Drejtorit të IEVP-së. Pendimi i të dënuarit duhet të rezultojë nga të dhëna objektive [...].*

28.13 Komisioneri Publik vlerëson se të dhënat e rezultuara në rastin konkret, duhen mbajtur në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në referim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe/ose në vlerësim tërësor të çështjes, në zbatim të nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

**29.** *Denoncimi i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a.*<sup>31</sup>, e cila pretendon mbi disa procese gjyqësore me objekt shpërblim dëmi, kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, dhe persona të tretë shoqëritë e sigurimit (f. 49 e vendimit të Komisionit).

29.1 Komisioni ka arritur në përfundimin se, nga verifikimi i denoncimit duket se ankimi i përket shqyrtimit të themelit të çështjes, garant i së cilës është gjykata e shkallës më të lartë. Në kushte të tilla, trajtimi i këtij denoncimi nuk është konsideruar në kompetencë të Komisionit (f. 49 e vendimit të Komisionit).

29.2 Komisioneri Publik konstaton se në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë nr. \*\*\*, datë \*.7.2018<sup>32</sup>, dhënë nga gjyqtari i vetëm, subjekti i rivlerësimit, me anë të të cilit është disponuar pranimi i padisë, përfaqësues ligjor i palës paditëse në proces, në cilësinë e avokatit, ka qenë dhe shtetasi \*\*\*.\*\*\*, shtetas ky me të cilin subjekti i rivlerësimit ka pasur një marrëdhënie huaje dhe interesi financiar në vitin 2012. Nga aktet në fashikullin e hetimit administrativ të Komisionit, duket se subjekti i rivlerësimit i ka dhënë shtetasit \*\*\*.\*\*\* një hua<sup>33</sup> në shumën 122.000 euro, pa interes. Në këto kushte, në rastin e denoncimit në fjalë, Komisioni duhej të kishte vlerësuar rastin dhe në një drejtim tjetër, atë të gjykimit në kushtet e konfliktit të interesit.

29.3 Nga aktet në fashikullin e hetimit administrativ të Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e zv/kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me shkresën nr. \*\*\* akti, datë \*.10.2020, ka informuar Komisionin<sup>34</sup> se nga verifikimi i kryer pranë indekseve alfabetikë civilë/penalë sistemi ICMIS nuk rezulton të jenë zhvilluar gjykime me shtetasin \*\*\*.\*\*\*, në cilësinë e paditësve, të paditur, të pandehur, nga subjekti i rivlerësimit Arben Dosti.

29.4 Komisioneri Publik, në gjendjen që janë aktet, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, në kushtet e një marrëdhënie pasurore të provuar me shtetasin \*\*\*.\*\*\*, duket se ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, gjatë ushtrimit të detyrës së tij si gjyqtar.

29.5 Në këtë vlerësim, Komisioneri Publik mban në konsideratë edhe qëndrimin e Kolegjit në raport me çështjet e konfliktit të interesit, ndër të tjera të shprehura dhe në vendimin e juridiksionit të rivlerësimit nr.10/2021, mbi interpretimin e konceptit të paanësisë, sipas Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore, si atë nr.16/2020.

29.6 Konflikti i interesit, sipas nenit 3, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.

29.7 Sa më sipër, duket se subjekti ndodhet në kushtet dhe situatën e konfliktit të interesit, në raport me kërkesat e nenit 5 të ligjit nr. 9367/2005, pika 1, germa “b”, “dh” dhe nënpika

<sup>31</sup> Ankesa nr. \*\*\* prot., datë \*.10.2018.

<sup>32</sup> Bashkëlidhur denoncimit të \*\*\* sh.a.

<sup>33</sup> Sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*.12.2012.

<sup>34</sup> Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*.10.2021, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me kërkesën për informacion nëse subjekti i rivlerësimit ka shqyrtuar çështje gjyqësore të ndryshme civile/penale me palë ndër-gjyqëse/kallëzues/të kallëzuar/të pandehur/të dëmtuar etj., ndër të tjerë, dhe me shtetasin \*\*\*.\*\*\*.



“v”, pasi nuk duhej të merrte pjesë në vendimmarrjen përkatëse, ku palë ndërgjyqëse ishte një shtetas me të cilin ka pasur një marrëdhënie preferenciale, juridiko-civile, apo angazhime të mëparshme miqësore.

**30.** Çështja penale me të pandehur shtetasin \*\*\*, \*\*\*, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 të Kodit Penal (f. 58-62 e vendimit të Komisionit).

30.1 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka dërguar për gjykim dhe ka kërkuar deklarin fajtor të shtetasit \*\*\*, \*\*\*, për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 të K. Penal, dhe dënimin me tre vjet e gjashtë muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të K. Pr. Penale, uljen e dënimit me 1/3, duke u dënuar përfundimisht me 2 vjet e 4 muaj burgim. Mbrojtësi ligjor i të pandehurit ka kërkuar të aplikohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit, parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal.

30.1.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.3.2017, e përbërë nga subjekti i rivlerësimit si gjyqtar i vetëm, ka vendosur deklarin fajtor të të pandehurit \*\*\*, \*\*\*, për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 të K. Penal, dhe dënimin me 3 (tre) vjet burgim. Në zbatim të nenit 406 të K. Pr. Penale dënimit i zbritet 1/3-ta, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin me 2 (dy) vjet burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të vendimit, duke e vendosur në provë të pandehurin \*\*\*, \*\*\*, për një periudhë prej 2 vjetësh, me kusht që gjatë kësaj periudhe prove të mos kryej vepër tjetër penale, si dhe të mbaj kontakte me Shërbimin e Provës, Gjirokastrë.

30.1.2 Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është ankimuar nga organi i Prokurorisë, lidhur me zbatimin e nenit 59, të Kodit Penal. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.9.2017, ndër të tjera, ka vendosur: [...] *ndryshimin e vendimit sa i përket mënyrës së vuajtjes së dënimit, duke u vendosur mosaplikimi i nenit 59 të Kodit Penal [...].*

30.1.3 Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka çmuar se në rastin në shqyrtim nuk duhet të aplikohet neni 59, i Kodit Penal, duke argumentuar se: [...] *kriteri bazë i aplikimit të këtij neni është rrezikshmëria e paktë e personit dhe plotësimi i disa kushteve të tjera, siç është mosha, kushtet shëndetësore etj. Nga studimi i rrethanave të ngjarjes rezulton se sasia e bimëve narkotike të mbjella nga i pandehuri është relativisht e lartë (rreth 466 rrënjë), gjë që flet për rrezikshmëri jo të paktë të të pandehurit \*\*\*, \*\*\*. Fakti që prindërit janë pensionistë, nuk justifikon aplikimin e nenit 59 të K. P. Gjithashtu, nuk provohet që i pandehuri është i punësuar e, për rrjedhojë, që me këto të ardhura mban familjen. Sa më sipër, Gjykata e Apelit, bazuar dhe në faktin që kjo vepër penale është shumë e përhapur e është bërë fenomen shqetësues si kombëtar, edhe ndërkombëtar, çmon se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë duhet të ndryshohet vetëm sa i përket aplikimit të nenit 59 të K. Penal [...].*

30.2 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij para Komisionit, ndër të tjera, ka deklaruar<sup>35</sup> se në vendimin e saj, Gjykata e Apelit shprehet se rrezikshmëria e të pandehurit është e lartë, për shkak të sasisë së bimëve narkotike të kultivuar. Por, në vendimmarrjen e tij, subjekti i rivlerësimit referon se ka marrë në konsideratë edhe fazën në të cilën ndodheshin këto bimë, të cilat ende nuk ishin të mbjella, pasi ishin në fazën inkubatore, dhe si rrjedhojë deri në ato

<sup>35</sup> Referohuni përgjigjeve të rezultateve të hetimit dhe vendimit të Komisionit f. 60-61.

momente nuk plotësonin asnjë kriter për t'u konsideruar të përdorshme dhe të rrezikshme për shëndetin e njerëzve. Në këtë këndvështrim, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se deri në arritjen e kohës për vjeljen e tyre, do të kalonin disa faza dhe një periudhë e gjatë kohore, me mundësinë e të pandehurit edhe për të hequr dorë nga vepra penale ose në dështimin e kultivimit të tyre. Vepra penale e kultivimit të bimëve narkotike është kryer në fshehtësi, duke pretenduar se ka një diferencë midis veprave penale të kryera në publik dhe atyre të kryera në fshehtësi, dhe se dallimi është tek fakti që veprat penale në fshehtësi nuk dihen dhe nuk ndikojnë drejtpërdrejtë në rendin dhe sigurinë publike.

30.3 Komisioni i ka vlerësuar bindëse shpjegimet e subjektit mbi vendimmarrjen e tij lidhur me këtë çështje dhe ka arritur në përfundimin se nuk ekzistojnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe/apo për figurën e subjektit të rivlerësimit (f. 62 e vendimit të Komisionit).

30.4 Komisioneri Publik konstaton se të dhënat e rezultuara nga hetimi administrativ i këtij rasti, duhen vlerësuar nga indikatorët e përcaktuar nga neni 72/3, i ligjit nr. 96/2016, lidhur me cilësinë e analizës dhe të argumentimit logjik të subjektit dhe duhen konsideruar në vlerësim tërësor të çështjes, së bashku me të dhënat e tjera të rezultuara nga kriteri i vlerësimit profesional të subjektit.

30.5 Argumentimi i subjektit të rivlerësimit se bima narkotike është në fazë inkubatori apo arsyetimi se veprat penale në fshehtësi nuk dihen dhe nuk ndikojnë drejtpërdrejtë në rendin dhe sigurinë publike, duke mos referuar bazën përkatëse ligjore ose ndonjë jurisprudencë unifikuese, duket se tregojnë për një mangësi në cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, për më tepër në kushtet kur bëhet fjalë për veprën penale të “Kultivimit të lëndëve narkotike”, gjërisht e përhapur dhe, për këtë arsye, e një rrezikshmërie të posaçme shoqërore.

30.6 Komisioneri Publik vlerëson se të dhënat e rezultuara në rastin konkret, duhen mbajtur në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në referim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe/ose të trajtohen në vlerësim tërësor të çështjes, në zbatim të nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

### **31. Trajtimi i informacioneve nga burimet e hapura (f. 62-64 të vendimit)**

31.1 Komisioni ka trajtuar në vendimin nr. 479 datë 3.12.2021, një informacion të përfutur nga burime të hapura, ku duket se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, ka vendosur masën e sigurimit personal “arrest shtëpie” për shtetasit \*\*\*.\*\*\*<sup>36</sup> dhe \*\*\*.\*\*\*, për të cilët raportohet se janë arrestuar në flagrancë me 58 kg lëndë narkotike të llojit *cannabis sativa*.

31.2 Pas kërkesës së bërë nga Komisioni<sup>37</sup>, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka dërguar<sup>38</sup> fashikullin e procedimit penal me nr. \*\*\*, i vitit 2017, regjistruar për veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, që lidhet me ngjarjen e referuar si më sipër, të raportuar në media. Subjekti i rivlerësimit ka

<sup>36</sup> Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*.5.2021, informon se për shtetasin \*\*\*.\*\*\*, prokurori i çështjes ka vendosur pushimin e çështjes me vendimin e datës \*\*.10.2017.

<sup>37</sup> Referohuni shkresës nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2021.

<sup>38</sup> Referohuni shkresës nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2021.

qenë gjyqtari që ka shqyrtuar vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit për shtetasin \*\*\*,\*\*\*.

31.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e përbërë nga subjekti i rivlerësimit gjyqtar i vetëm, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2017, ka vendosur: (i) vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe (ii) caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në shtëpi” me mbikëqyrje elektronike, parashikuar nga neni 237 i K. Pr. Penale dhe ligji nr. 10496/2011, “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”.

31.4 Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Gjykata e Apelit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.7.2017, ka vendosur: (i) miratimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë sa i përket disponimit për vleftësimin “arrest në flagrancë” ndaj personit nën hetim \*\*\*,\*\*\*; (ii) ndryshimin e këtij vendimi sa i përket disponimit për caktimin e masës së sigurimit, duke i dhënë masën e “arrestit me burg”, sipas nenit 238 të K. Pr. Penale.

31.5 Gjykata e Apelit ka vlerësuar ndryshe lidhur me elementet e: (i) rrezikut të ikjes; (ii) mundësisë që personi nën hetim të ndërhyjë në procesin e drejtësisë; dhe (iii) përshtatshmërisë së masës së sigurimit në raport me sanksionin penal të parashikuar për veprën penale për të cilën ky person dyshohej të ketë kryer.

31.6 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij, ndër të tjera, ka referuar se në trajtimin e çështjes penale, pas kërkesës së prokurorit për vleftësimin e ligjshëm të arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë “arrest me burg”, në vendimin e tij është shprehur se: *[...]Gjykata vëren se masa e sigurimit nuk është masë ndëshkimore për personin që dyshohet se ka kryer një veprë penale dhe, nga ana tjetër, nuk jepet për të lehtësuar punën e organit të Prokurorisë në hetimin e çështjes penale, por ajo duhet të aplikohet vetëm në zbatim të shkaqeve, kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në mënyrë të qartë në nenet 228, 229, dhe 230 të K. Pr. Penale. Për më tepër, masa e sigurimit personal nuk njësohet me dënimin penal, pasi është një veprim procedural që kufizon përkohësisht lirinë e personit ndaj të cilit po zhvillohet procedimi penal. Ky kufizim është i përkohshëm dhe shkalla e tij varet nga nevoja konkrete të procesit të hetimit [...].*

31.7 Komisioni, pa i hyrë logjikës së arsytimit dhe vlerësimit mbi vendimmarrjen që lidhet me themelin e çështjes, ka çmuar se, edhe në këtë rast, ajo është bazuar në bindjen e brendshme të subjektit të rivlerësimit, në verifikim dhe analizë të kushteve/kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara nga legjislacioni penal për caktimin e masës së sigurimit personal dhe llojit të saj. Komisioni i ka gjetur bindëse shpjegimet e subjektit mbi vendimmarrjen e tij lidhur me këtë çështje dhe, si rrjedhim, ka arritur në përfundimin se nuk ekzistojnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe/apo për figurën e subjektin e rivlerësimit, gjyqtarit Arben Dosti.

31.8 Komisioneri Publik, nisur nga rrethanat konkrete, vlerëson se të dhënat e rezultuara nga hetimi administrativ i rastit, lidhur me cilësinë e analizës dhe të argumentimit logjik të subjektit, duhen vlerësuar nga indikatorët e përcaktuar nga neni 72/3, i ligjit nr. 96/2016 dhe, si të tilla, duhen parë në vlerësim tërësor të çështjes së bashku me të dhënat e tjera të rezultuara nga kriteri i vlerësimit profesional të subjektit.

31.9 Komisioneri Publik vlerëson se të dhënat e rezultuara në rastin konkret, duhen mbajtur në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në referim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe/ose të trajtohen në vlerësim tërësor të çështjes, në zbatim të nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

32. Nga Raporti i vlerësimit profesional të hartuar nga KLGJ-ja, ndër të tjera, për subjektin e rivlerësimit ka rezultuar si më poshtë:

32.1 Aftësitë profesionale: (i) Në një rast është konstatuar se gjyqtari nuk ka disponuar me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e procesit në mungesë të palës së paditur (shih dosjen 5); (ii) Në dy raste është vërejtur se në vendimin përfundimtar gjyqtari nuk ka përcaktuar palën të cilit i ngarkohen shpenzimet referuar nenit 106 të K. Pr. Civile (shih dokumentin 2 dhe dosjen 1); (iii) Ndërsa, në dy raste të tjera, konstatohet se gjyqtari nuk ka disponuar për heqjen e masës së sigurimit të caktuar ndaj të pandehurit, në kundërshtim me detyrimin e parashikuar në nenin 389 të K. Pr. Penale (shih dokumentin 1 dhe dosjen 4).

32.2 Arsyetimi ligjor: (i) Në rastet e zgjidhjes së martesës, gjyqtari përdor në mënyrë të standardizuar paragrafë me referencë të kuadri ligjor i aplikueshëm, por konstatohet se në këto vendime pjesa arsyetuese paraqitet përgjithësisht teorike, nuk analizohet asnjë provë apo pohim gjyqësor mbi bazën e të cilave gjyqtari të ketë arritur në konkluzionin se padia duhet pranuar (shih dokumentin 2 dhe dosjen 1); (ii) Gjithashtu në një prej këtyre vendimeve mungon analiza konkrete rreth nevojave të fëmijëve dhe mundësisë së prindërve për caktimin e masës së pensionit ushqimor në favor të fëmijëve të mitur (shih dokumentin 2). Në 1 rast gjykimi të një çështje civile me objekt përmbushje detyrimi nuk përdoret një metodologji e caktuar në arsyetimin e vendimit dhe konstatohet se arsyetimi është i qartë, i kuptueshëm, por pa ndonjë analizë të thelluar (shih dosjen 5); (iii) Përgjithësisht, në 3 dokumentet dhe 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se gjyqtari nuk citon provat, mbi të cilat palët kanë provuar faktet e pretenduara prej tyre; (iv) Në dy raste është vërejtur se në vendimin përfundimtar gjyqtari nuk ka përcaktuar palën të cilit i ngarkohen shpenzimet, referuar nenit 106 të K. Pr. Civile (shih dokumentin 2 dhe dosjen 1). Ndërsa, në dy raste të tjera, konstatohet se gjyqtari nuk ka disponuar për heqjen e masës së sigurimit të caktuar ndaj të pandehurit (shih dokumentin 1 dhe dosjen 4).

32.3 Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore: (i) Tek 1 çështje penale e vëzhguar, planifikimi i seancës së parë gjyqësore është planifikuar për një afat 9 ditë, duke mos u respektuar afati 10-ditor i njoftimit të të pandehurit para datës së zhvillimit të seancës të parashikuar nga neni 333/2 të K. Pr. Penale (shih dosjen 3).

32.4 Komisioni, në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit për gjetjet e listuara në këtë raport, ka çmuar se: [...] nuk konstatohen problematika thelbësore lidhur me vlerësimin e kriterit profesional [...] (f. 43 e vendimit).

32.5 Komisioneri Publik, nisur nga rrethanat konkrete, vlerëson se të dhënat që përmban raporti i vlerësimit profesional të hartuar nga KLGJ-ja, duhen mbajtur në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në referim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe/ose të trajtohen në vlerësimin tërësor të çështjes, në zbatim të nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

32.6 Sa më lart, Komisioneri Publik, në analizë të provave dhe akteve të administruara, vlerëson se përfundimi i Komisionit në rivlerësimin e kriterit të aftësive profesionale është i cenueshëm. Referuar rezultateve të hetimit administrativ mbi kontrollin e kriterit të aftësive profesionale, referuar nenit 4, pika 2, nenit 61, pika 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, duket se mangësitë e vërejtura janë të tilla, që nuk justifikojnë ose të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit duhet të konfirmohet në detyrë.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

33. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka vendosur Komisioni për kriteret e rivlerësimit, duke marrë për bazë gjendjen e fakteve dhe provave në rastin konkret dhe të ligjit të zbatueshëm;

34. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

35. Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit në mënyrë kumulative nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e të tria kriterëve të procesit të rivlerësimit dhe, për pasojë, vendimi nr. 479, datë 3.12.2021, i Komisionit, nuk konsiderohet i drejtë dhe nuk duhet lënë në fuqi;

36. Bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenet 30-44, nenin 4, pika 2, dhe nenin 61, pikat 2, 3, 4 dhe/ose 5, të ligjit nr. 84/2016;

37. Komisioneri Publik kërkon, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 479, datë 3.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dosti.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**